



# 2021 RAPORTI VJETOR



# MESAZHI NGA DREJTORI EKZEKUTIV

Të dashur miq të Teach For Kosova,

Viti 2021 qe një vit i zhvillimit të mëtutjeshëm të organizatës sonë; ne rritëm numrin e Fellows tanë, zhvilluam më tej partneritetet tona institucionale dhe lokale, zgjeruam shtrirjen tonë në më shumë komuna dhe filluam të shohim ndikimin që Fellows tanë të të dy kohortave e kanë nëpër klasat ku japin mësim.

Pandemia ishte sfida me të cilën u përballëm edhe këtë vit. Ajo vazhdon të ndikojë ende te nxënësit dhe shkollat. Mirëpo, përgjatë 2021 ne mësuam dhe u informuam më mirë se si mund të kemi më shumë ndikim pozitiv si organizatë.

Në kuadër të Institutit Veror të Teach For Kosova e mbajtur verën e kaluar me kohortën e dytë, për herë të parë u mbajt Shkolla e Parë Publike Verore në Prishtinë, e cila u mundësoi Fellows të punojnë drejtpërdrejt me nxënës dhe të përgatiten për Fellowshipin dyvjeçar.

Teach For Kosova shquhet për diversitetet e kjo vërehet edhe nga llojllojshmëria e komunave dhe etnive nga të cilat vijnë Fellows tanë. Ky diversitet mundësoi që këta të rinj gjatë Institutit Veror patën rastin të mësonin më shumë nga përvojat e shkëmbyera me njëri-tjetrin. 20 Fellows u vetëdijësuan për çështjet që e pengojnë funksionimin e mirëfilltë të sistemit arsimor në Kosovë. Ata u pajisën me aftësitë dhe shkathtësitë e duhura për fillimin e rrugëtimit të tyre si avokues të përhershëm për cilësi dhe barazi në arsim.

Trajnimi i Institutit Veror të Teach For Kosova u akreditua nga MAShT dhe organizata krijoi partneritetin e saj të parë me Ministrinë e Arsimit.

Përtej Fellowshipit, Teach For Kosova gjithashtu implementoi edhe projekte të tjera edukative në të gjithë Kosovën. Ajo bashkëpunoi me VoRAE (Voice of Roma, Ashkali and Egyptians) për ngritjen e kapaciteteve të të rinjve përfshirë të rinjtë e komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian përmes edukimit joformal të cilët u aftësuan që të fuqizojnë dhe promovojnë drejtësinë sociale, qytetarinë aktive dhe vlerat demokratike.

Më tej, Teach For Kosova zhvilloi 10 klube të debatit nëpër shkollat e mesme të larta në mbarë Kosovën përmes projektit "Let's Debate Change", projekt i cili u dizajnuar dhe u implementua nga organizata jonë. Klubet e debatit u dhanë nxënësve qasje tek udhëheqësit komunal për të shprehur shqetësimet për shkollat e tyre dhe më e rëndësishmja u mësuan atyre se si të debatojnë dhe avokojnë për veten dhe ndryshimet pozitive në shoqëri.

Gjersa përfundojmë vitin e dytë, Teach For Kosova është entuziaste të sjellë një grup të ri dhe të larmishëm mesimdhënësish të kohortës së tretë. Ajo do të thellojë bashkëpunimet me shkollat dhe do të monitorojë ndikimin e 33 Fellows tanë për të sjellë ndryshimet që i nevojiten dhe i meriton sistemi arsimor i Kosovës.

Faleminderit që jeni përkrahës dhe miq të Teach For Kosova!

Mezi presim që të vazhdojmë punën tonë për t'u siguruar që të gjithë fëmijët e Kosovës kanë qasje në një sistem arsimor të cilësisë së lartë.

Egzon Gashi



# BORDI I TEACH FOR KOSOVA



Athena Palmer



Vedat Gashi

“ Së bashku mund të bëjmë ndryshime ”



Armend Berisha



Fatmir Krasniqi

# REFLEKTIM MBI VITIN E KALUAR

Në vitin 2021, Teach For Kosova zgjeroi programin e saj të Fellowshipit, përforcoi partneritetet me akterët lokalë dhe qendrorë dhe përmes projekteve të shumta thelloi ndikimin e saj në komunitetet në mbarë Kosovën.




## Ngjarjet kryesore nga viti 2021

- Programi ynë u akreditua nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë
- Rekrutuar 20 Fellows të Kohortës së Dytë
  - 90% e pjesëmarrësve ishin vajza/gra. 15% e tyre ishin nga komunitetet pakicë
- Formalizuar partneritetin me 10 komuna (Drejtori Komunale të Arsimit)
- Formalizuar partneritetin me 5 Universitete Publike në Kosovë për rekrutimin e Fellows të ardhshëm
- Për herë të dytë organizuar Institutin Veror të trajnimit (5 javë/25 ditë trajnime intensive në leadership dhe mësimdhënie)
- Për herë të parë organizuar Shkollën Verore; 3 javë shkollë verore me 85 nxënës
- Implementuar projektet: "Let's Debate Change", "Hear Us – VoRAE" dhe "Community Impact Fund"
- Vendosëm 10 mësimdhënës të rinj në shkolla publike (filllore e të mesme)
- Udhëhoqëm fokus grupe dhe sesione informuese me studentë të Universiteteve Publike të Kosovës
- Hapëm thirrjen për aplikime për Kohortën e Tretë të programit të Fellowshipit


# KOHORTA E DYTË

Në vitin 2021, Teach For Kosova rekrutoi, trajnoi, dhe vendosi Kohortën e Dytë të 20 liderëve të rinj të jashtëzakonshëm. Ne vazhdojmë të rekrutojmë dhe të zgjerojmë forcën udhëheqëse kolektive, e cila do të punojë të krijojë ndryshim sistematik.


## Etniciteti



## Fushat e Studimit



## Rekrutimi 2020-2021



- 240 aplikacione të pranuar;
- 60 aplikantë të ftuar në Qendrën e Vlerësimit;
- 20 Fellows të pranuar;

8.3% e aplikantëve u pranuan

# HARTA E MBULUESHMËRISË



# KOHORTA E DYTË



GËZIM QEHAJA

**Vendlindja:** Gjakovë, Kosovë  
**Bachelor:** Shkencat kompjuterike  
**Master:** Shkencat kompjuterike

Jam Gëzim Qehaja, 28 vjeçar, nga Gjakova.

Studimet Bachelor i përfundova në lëmin e Shkencave Kompjuterike, në Universitetin "Ukshin Hoti" në Prizren. Studimet master i vazhdova në të njëjtin universitet, ku tanimë jam absolvent.

Që nga viti 2011 jam marr me qytetari aktive, projekte që kanë të bëjnë me komunitetet dhe problemet që na preokupojnë si shoqëri.

Qysh atëherë jam kyçur në shumë organizatata, kam ndjekur shumë trajnime me fokus në problematikat qytetare vendore dhe ato me karakter profesional akademik.

Kam përfunduar dhe një sërë praktikash me karakter teknik dhe profesional në ndërmarrje, organizata, institucione, e të ngjajshme, në lëminë e energjisë dhe efijencës së energjisë.

Praktika në BONEVET më ofroi më afër asaj se çfarë dua. Këtu fillova punën si praktikant e më pas si asistent teknik. Kjo hapësirë krijuese më ndihmoi të forcoj punën teknike profesionale dhe me vonë udhëhoqa edhe dy projekte në ndërtimin e dy paisjeve teknike me fëmijë të moshave 14-16 vjeçare.

Së fundmi aplikova në Teach For Kosova dhe u zgjedha si ndjekës i programit. Jam shumë i entuziazmuar që jam pjesë e programit dhe që së bashku me pjesëmarrësit e tjerë, në një të ardhme të afërt, ta reformojmë dhe të kontribuojmë në cilësinë e arsimit në vend.

Mendoj që një mësimdhënës i suksesshëm është student gjatë gjithë jetës së tij prej mësimdhënësi, dhe i tillë do të doja të isha.



LEURITA SELMANI

**Vendlindja:** Ferizaj, Kosovë  
**Bachelor:** Fakulteti i Filologjisë - Dega Gjuhë Shqipe  
**Master:** Vazhdon të njëjtin drejtim

Jam Leurita Selmani, 26 vjeçare, nga Ferizaji.

Kam përfunduar studimet themelore në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina", në Fakultetin e Filologjisë, dega Gjuhë shqipe, ndërsa tani jam në përfundim të studimeve Master në po të njëjtin drejtim.

Përveç studimeve edhe kontributi në shoqëri ka qenë shumë i rëndësishëm për mua. Aktualisht punoj si vullnetare në organizatën "The Library Project - Kosova", e cila ka për qëllim t'i motivojë fëmijët dhe të rinjtë në Kosovë të jenë lexues gjatë gjithë jetës.

Ajo që gjithmonë më ka zgjuar interesim ka qenë fusha e edukimit, sidomos duke e pasur parasysh nivelin e ulët të cilësisë së arsimit në vendin tonë.

Prandaj më bën shumë të lumtur fakti që jam pjesë e fellowshipit të Teach For Kosova, me të cilën besoj se do të arrijmë të sjellim reforma në arsim dhe, pse jo, në të ardhmen të jemi si model në mësimdhënie dhe/ose lidërsip.

Ndikimi i një mësimdhënësi në edukimin e një shoqërie është shumë i rëndësishëm, ku të mirat ose pasojat e tij zgjasin me vite, andaj duhet të kemi kujdes se cilën zgjedhim të bëjmë për shoqërinë.



Kur shoh entuziazmin te secili fellow, shoh atë dritën në fund të tunelit. Shoh se gjithçka është e mundur dhe besoj se mund të bëjmë një ndryshim. Mund të mos jetë diçka e madhe që bën kaq shumë zhurmë në vend, ndoshta diçka e vogël, një ndryshim që nis nga klasa ime e ardhshme.

- Donjeta SHATRI, Fellow

# INSTITUTI VEROR 2021 NJË VËSHTRIM MË I AFËRT



- Trajnuam 20 Fellows të jashtëzakonshëm;
- 200 orë trajnime përgjatë 5 javëve;
- Në anketën tonë të mbajtur pas institutit, për të dytën herë radhazi, 100% të Fellows deklaruan se do t'ua rekomandonin programin tonë të fellowship-it miqve apo të afërmve.



- 15 mysafirë të fushave të ndryshme ishin të ftuar të flasin dhe të diskutojnë mbi këndvështrimet e tyre rreth arsimit dhe udhëheqësisë;
- Dy prej mysafirëve tanë të dalluar ishin edhe Kryeministri Albin Kurti si dhe Presidentja e Republikës së Kosovës Vjosa Osmani.





# SESIONET E TRAJNIMIT NJË VËSHTRIM MË I AFËRT



## Instituti Veror

Nga 12 korriku deri më 13 gusht, Teach For Kosova së bashku me 20 Fellows të jashtëzakonshëm nga kohorta e dytë, mbajti Institutin Veror 2021. Secila ditë e Institutit përmbante një mori aktivitete të ndryshme, trajnime me sesione të fasilituara, diskutime grupore etj.

Fellows tanë patën mundësinë të njohin koncepte të ndryshme të lidhura me mesimdhënien, udhëheqësinë, ndërtimin e marrëdhënieve me palët e interesit në arsim, e shumë më shumë se kaq.

Pjesa kryesore e Institutit Veror 2021 ishte organizimi i Shkollës së Parë Publike Verore.

## Trajnimet shitesë

Edhe gjatë vitit 2021 është vazhduar me trajnime mujore tematike, trajnime këto që ofrohen për të gjithë Fellows gjatë kohës së tyre të shërbimit si mesimdhënës.

Gjatë këtyre trajnimeve mujore, Fellows tanë përfitojnë nga prezantimet që stafi i Teach For Kosova përgatitë për ta si dhe kanë rastin të zhvillojnë diskutime mbi tema që prekin arsimin në Kosovë, me theks të veçantë problemet që ata hasin gjatë shërbimit të tyre nëpër shkolla publike të vendit. Disa herë, Fellows kanë pasur rastin të zgjedhin vetë temat e trajnimeve të radhës.

Në fund të vitit, Fellows e dy kohortave u bënë bashkë në një punëtori dyditore, ku patën rastin, përveç njohjes më të mirë me njëri-tjetrin, edhe të punojnë në hartimin e një formulari që do të përdoret nga stafi i Teach For Kosova për të monitoruar punën e tyre nëpër klasa.

# SHKOLLA VERORE 2021 NJË VËSHTRIM MË I AFËRT

Si pjesë e Institutit Veror 2021, Teach For Kosova, në partneritet me Komunën e Prishtinës, mbajti Shkollën e parë Publike Verore në Kosovë.

Përgjatë tri javëve në Institut Veror, Fellows tanë patën mundësinë të praktikojnë mësimdhënien me nxënësit të cilët morën pjesë.

Nxënësit e përzgjedhur nga shkollat fillore të Prishtinës, përfituan nga orët mësimore atraktive të mbajtura nga Fellows tanë. Fellows ishin të monitoruar nga stafi i Teach For Kosova dhe pas secilës orë mësimore pranonin *feedback*.



- Dhjetra orë mësimore të zhvilluara
- 85 nxënës nga 5 shkolla të kryeqytetit
- 15 ditë mësimi atraktiv, inkluziv nga 19 Korriku deri më 6 Gusht
- Disa nga lëndët shkollore të ligjëruara ishin edhe: Mitologjia Shqipe, Biologjia, Kultura dhe Diversiteti, Edukimi Emocional dhe Mendor, si dhe Teknologjia e Informacionit
- Monitorim nga stafi i Teach For Kosova në secilën orë mësimore
- Anketa, pyetsorë, hulumtime
- Aktivitete jashtëkurrikulare



# “LET’S DEBATE CHANGE”

TFK bashkoi forcat me Solidar Suisse, një organizatë internacionale, misioni i së cilës është të përmirësojë jetën e të rinjve në mbarë Kosovën.

Së bashku, të dy grupet sponsoruan një program debati që do t'u jepte të rinjve aftësitë e nevojshme për të krijuar argumente bindëse. Që nga kryerja e hulumtimeve e deri te prezantimet e tyre, gjimnazistëve nga katër komuna u dha mundësia të shfaqnin ato që i kishin mësuar në garat me njëri-tjetrin.

Ata të cilët morën pjesë në këto punëtori treguan se trajnimi u ka ndihmuar atyre të mësojnë për kulturën e debatit dhe të ngrisin zërin për çështjet që i preokupojnë si në shkollë ashtu edhe në komunitet.

Nxënësit gjithashtu patën mundësinë t'i shprehnin mendimet e tyre përpara udhëheqësve në pushtet.

Ekipet nga Obiliqi, Peja dhe Istogu u takuan me përfaqësues të komunave për të diskutuar se si udhëheqësit mund t'i adresojnë pengesat me të cilat përballen të rinjtë. Përveç ndarjes së shqetësimeve të tyre, pjesëmarrësit u angazhuan në një diskutim me zyrtarët për tema që variojnë nga bullizmi deri te sipërmarrja.

Pas diskutimeve nxënësit u ndjenë të fuqizuar për t'u përfshirë më shumë në çështjet që i takojnë komunitetit të tyre, duke zbatuar aftësitë që kanë fituar gjatë punësive për qytetari aktive.



# "HEAR US!" – VoRAE

Në vjeshtë, TFK nisi një fushatë për të rritur ndërgjegjësimin për anti-gjipsizmin në Kosovë së bashku me Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE), një organizatë e dedikuar për të luftuar për të drejtat e minoriteteve.

Fellows të kohortës së dytë gjithashtu morën trajnime se si të merreshin me diskriminimin brenda dhe jashtë klasës.

Qëllimi i këtyre përpjekjeve ishte të fuqizojmë të rinjtë që të promovojnë gjithëpërfshirjen në mbarë vendin.

Për më tepër, TFK dhe VoRAE organizuan një sërë aktivitete të fokusuara në mënyrën se si njerëzit mund të ndër marrin veprime për të adresuar paragjykimet. Grupet u mbledhën së bashku për ngjarjet "Living Library" në katër komuna, ku mbi 300 njerëz nga sfone të ndryshme u angazhuan në dialog të hapur se si të avancohet drejtësia sociale.

Gjithashtu TFK dhe VoRAE realizuan një seri maratonash në qytete të ndryshme, në të cilat të rinjtë vrapuan për të rritur ndërgjegjësimin e publikut për pabarazitë sistematike. Ne besojmë se këto projekte kanë bërë një ndryshim duke mbështetur misionin tonë për eliminimin e pabarazive që gjenden në shoqëri në përgjithësi.

- Një javë e Institutit Veror iu kushtua ngritjes së vetëdijësimit rreth anti-gjipsizmit
- 4 murale në 4 qytete të ndryshme
- 4 mini maratona me të rinj të komuniteteve të ndryshme
- Sesion informues për grantin "Kujtim Veseli"



# “COMMUNITY IMPACT FUND” - TEACH FOR ALL

Përmes ‘Community Impact Fund’ është themeluar/konsoliduar Klasa për Mësim Plotësues për nxënësit të cilët kanë humbur orë mësimore si pasojë e pandemisë Covid-19:

- Zhvilluam një hulumtim kualitativ me 50 me fëmijë, prindër dhe mësimdhënës në ShFMU "Mihal Grameno" në Komunën e Fushë-Kosovës.
- Nëpërmjet hulumtimit identifikuam sfidat me të cilat nxënësit ballafaqohen në shkollë, duke përfshirë boshllëqet në procesin mësimor, socializimin, si dhe pasojat e pandemisë COVID-19.
- Mësuam rreth qasjes së mësimdhënësve ndaj nxënësve karshi pasojave të pandemisë COVID-19.



Bazuar në hulumtimin tonë formuam klasën për mësim plotësues në ShFMU "Mihal Grameno", në Fushë Kosovë.

- 95 nxënës, të përzgjedhur në bashkëpunim me mësimdhënësit.
- Katër herë në javë mësim plotësues
- Katër Fellows të Teach For Kosova të angazhuar si mësimdhënës për mësim plotësues.



# PARTNERËT STRATEGJIK



## Teach For All

Teach For All i ofron mbështetje të vazhdueshme Teach For Kosova, ndërsa organizata vazhdon të rritet dhe të zhvillohet. Puna jonë me Teach for All është formalizuar nëpërmjet një Memorandumi të Mirëkuptimit të nënshkruar në Nëntor të 2020-ës.

# 01

**DRC** DANISH  
REFUGEE  
COUNCIL



Teach For Kosova me përkrahjen e Danish Refugee Council dhe Community Development Fund, nga 12 korriku deri më 13 gusht, së bashku me 20 Fellows të jashtëzakonshëm nga kohorta e dytë, mbajti Institutin Veror 2021. Secila ditë e Institutit përmbante një mori aktivitete të ndryshme, trajnime me sesione të fasilituara, diskutime grupore etj.



# 02

# PARTNERËT STRATEGJIK



VOICE OF ROMA, ASHKALI  
AND EGYPTIANS IN KOSOVO

Në vjeshtë, Teach For Kosova nisi një fushatë për të rritur ndërgjegjësimin për anti-gjipsizmin në Kosovë së bashku me Voice of Roma, Ashkali and Egyptians (VoRAE), një organizatë e dedikuar për të luftuar për të drejtat e minoriteteve. Fellows të kohortës së dytë gjithashtu morën trajnime se si të merreshin me diskriminimin brenda dhe jashtë klasës.

# 03



TFK bashkoi forcat me Solidar Suisse, një organizatë internacionale, misioni i së cilës është të përmirësojë jetën e të rinjve në mbarë Kosovën.

Së bashku, të dy grupet sponzoruan një program debati që do t'u jepte të rinjve aftësitë e nevojshme për të krijuar argumente bindëse. Që nga kryerja e hulumtimeve e deri te prezantimet e tyre, gjimnazistëve nga katër komuna u dha mundësia të shfaqnin ato që i kishin mësuar në garat me njëri-tjetrin.



# 04

# PARTNERËT STRATEGJIK



05





# PARTNERËT STRATEGJIK

## PARTNERITETET ME SEKTORIN PUBLIK

Komuna e Prishtinës  
Komuna e Fushë Kosovës  
Komuna e Kamenicës  
Komuna e Ferizajit  
Komuna e Prizrenit  
Komuna e Gjakovës

Komuna e Malishevës  
Komuna e Drenasit  
Komuna e Deçanit  
Komuna e Pejës  
Komuna e Mitrovicës

## PARTNERITETET NË MES TË ORGANIZATAVE

Germin  
Roma Versitas Kosovo

SBASHK  
Voice of Roma, Ashkali & Egyptians

## PARTNERITET ME UNIVERSITETE

Universiteti i Mitrovicës  
"Isa Boletini"

Universiteti i Pejës  
"Haxhi Zeka"

Universiteti i Shkencave të Aplikuara  
në Ferizaj

Universiteti i Gjakovës  
"Fehmi Agani"

Universiteti i Prizrenit  
"Ukshin Hoti"

Universiteti i Prishtinës  
"Hasan Prishtina"

# STAFI JONË



**Egzon Gashi**  
*Drejtore Ekzekutiv*



**Anita Plakolli**  
*Drejtore për Zhvillim*



**Visar Kurti**  
*Menaxher i Financave*



**Kastriot Muçolli**  
*Menaxher i Zyrës*



**Valmira Morina**  
*Menaxhere e Projekteve*



**Erlinda Musliji**  
*Tutore*

**BASHKOHU NË BISEDË**

@teachforkosova





**Teach***for*  
**KOSOVA**

## LËVIZJE PËR ARSIM CILËSOR



Në një të ardhme, të gjithë fëmijët e Kosovës – pa marrë parasysh prejardhjen apo etninë – do të kenë qasje në një sistem arsimor që i përgatitë ata për një sukses të përjetshëm.



+383 49 170 597  
[www.teachforkosova.org](http://www.teachforkosova.org)

Prishtina  
Rr. Sylejman Vokshi 13/5  
Prishtina, Kosova, 10000